

## KONKURS

### Projektimi arkitektonik i standave dhe tregut mobil të fermerëve në Prishtinë

Projekti “Themelimi i tregut mobil të fermerëve në Prishtinë”, i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe i implementuar nga Komuna e Prishtinës, në partneritet me OJQ “Gratë në Biznes” dhe OJQ “CEED Kosova”, shpall konkurs dhe fton të gjitha kompanitë e autorizuar dhe të interesuara të konkurojnë me koncept projekte për projektimin arkitektonik të standave dhe tregut mobil të fermerëve në Prishtinë.

Komuna e Prishtinës, në cilësinë e koordinatorit të projektit, do të themelojë tregun mobil të fermerëve në Prishtinë, i cili do të vendoset në mënyrë lëvizëse në nëntë (9) lagje të ndryshme në qytetin e Prishtinës, ku fermerët dhe prodhuesit e Rajonit ekonomik Qendër do të mund të shesin prodhimet e tyre bujqësore dhe artizanale, me shumicë dhe pakicë, në tenda të hapura apo gjysëm të hapura.

Të gjitha koncept projektet që do të konkurojnë në këtë konkurs, do të vlerësohen nga një juri profesionale e themeluar nga Komiteti Drejtues i këtij projekti. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të Koncept Projekteve në bazë të përgjegjshmërisë së tyre, sipas kërkesave teknike dhe/ose estetike, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret, dhe sistemin e pikëve të caktuara nga juria profesionale. Pas vlerësimit të Koncept Projekteve, juria do të shpallë dy fituesit e këtij konkursi, të cilët do të shpërblehen me çmimet fituese në total prej 1,400 euro.

Çmimi i parë do të shpërblehet me 1,000.00 euro

Çmimi i dytë do të shpërblehet me 400.00 euro

Fituesi i çmimit të parë do të kontraktohet gjithashtu për të punuar edhe dosjen tenderuese për furnizim me 100 stenda për tregun mobil të fermerëve në Prishtinë dhe për këtë do të shpërblehet me 1,000.00 euro shtesë.

Dosja e Detyrës Projektuese mund të kërkohet në adresën elektronike [info@gratenebiznes.com](mailto:info@gratenebiznes.com) prej datës 20 korrik 2015.

Data e fundit për dorëzimin e Detyrës Projektuese të kompletuar është data 03 gusht 2015 ora 16:00.

Detyra Projektuese duhet të dorëzohet e kompletuar në zarf të mbyllur, në zyrën e “Gratë në Biznes”, Rruga “Zeki Shulemaja”, Kati 1/nr.2-1, 10000 Prishtinë.

Çdo pyetje shtesë rreth këtij konkursi mund të adresohet me shkrim në adresën elektronike [info@gratenebiznes.com](mailto:info@gratenebiznes.com).

